



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



### EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së tretë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 22.3.2012, e cila filloi në orën 11:00.

**Në mbledhje morën pjesë:** Avdullah Hoti, nënkryetar i Komunës, Sami Hamiti, kryesues i Kuvendit, këshilltarët: Hazir Borovci, Shaip Hajrizi, Bekim Gashi, Hetem Kupina, Vjollca Dibra - Ibrahim, Rrahman Ismajli, Rexhep Mustafa, Avdush Dobratiqi, Premtina Rakovica, Muhamet Nura, Vjollca Rizani, Ajnishahe Azemi, Mustafë Krasniqi, Sarandë Sadriu, Arta Krasniqi, Luan Jusufi, Sali Krasniqi, Tefik Mehmeti, Fetah Salihu, Naime Osmani, Bajram Selimaj, Shefki Uka, Musli Mehaj, Agim Krasniqi, Flamur Shala, Nexhmije Berisha, Aziz Pacolli, Remzi Pacolli, Milazim Vitia, Naim Makolli, Donika Surdulli, Nerxhivane Vitia, Sofije Kllokoqi, Valon Hiseni, Shemsi Veseli, Liridon Restelica, Skënder Reçica, Besa Halimi – Zagragja, Lumnie Rama, Shefqet Sylejmani, Mejreme Berisha, Shefki Gashi, Besa Rafuna, Feti Mejdiu, Kimet Zeqa dhe Sadri Ramabaja.

**Munguan:** Meliza Haradinaj, Astrit Hasani, Afërdita Veliu dhe Engin Beyoglu.

**Morën pjesë edhe** drejtorët e drejtorive, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, të OSBE – së, të mjeteve të informimit dhe përfaqësuesit e ndërmarrjeve publike lokale.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Sami Hamiti**, kryesues i Kuvendit.

**Sadri Ramabaja** kërkoi që në pikën “Të ndryshme” të futet për diskutim një reagim publik.

**U konstatua se njëzëri u miratua ky**

### REND DITE :

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë;
2. Informata e kryeshefit të ekzekutivit të kompanisë së ujësjellësit rajonal “Prishtina” SH A për investimet në përmirësimin e furnizimit me ujë në komunën e Prishtinës;
3. Raportet vjetore të komisioneve të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale:
  - a) “Hortikultura”,
  - b) “Termokos”,
  - c) “Pastrimi”,
4. Pyetje dhe përgjigje;
5. Të ndryshme.

## **Pika e parë**

**Kimet Zeqa** bëri vërejtje në ekstrakt, duke thënë se mungon një pjesë e diskutimit rreth raportit vjetor, që ka të bëjë kryesisht për shëndetësinë. Mungojnë shifrat rreth të punësuarve në stomatologji, brenda periudhës 2010-2011. Gjithashtu pata kërkuar sqarime lidhur me ndërtimin e QMF-së në Prishtinë dhe ndërtimin e morgut dhe për këtë përgjigje nuk më është dhënë.

Megjithëse disa kërkesa i kam bërë me shkrim, nuk kam marrë asnjë përgjigje, ndoshta edhe pasi që nuk po funksionon Komiteti për shëndetësi, ndoshta janë disa probleme që duhet të diskutohen edhe në Komitetin për shëndetësi.

**Me vërejtjen e dhënë, njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së dytë.**

## **Pika e dytë**

Lidhur me investimet në përmirësimin e furnizimit me ujë në komunën e Prishtinës, informoi **Gjelosh Vataj**, kryeshef ekzekutiv i ujësjellësit rajonal "Prishtina" SH A, i cili dha një informatë rreth furnizimit me ujë të qytetit të Prishtinës, për sfidat me të cilat ballafaqohet kjo kompani, si dhe rreth investimeve vetjake dhe të donatorëve që është duke i bërë ujësjellësi rajonal.

**Fetah Salihu** ( Ka folur pa e kyçur mikrofonin dhe nuk është dëgjuar pyetja.)

**Sadri Ramabaja** ngiti shqetësimin e një grupi të qytetarëve të lagjes "Dardania" rreth faturave mujore të ujit, që me rastin e vendosjes së orëve të reja nga ujësjellësi, faturat mujore janë për 30 % më të shtrenjta.

Çështje tjetër shqetësuese është se nga liqeni i Badovcit është i projektuar edhe furnizimi me ujë për lagjen Lugmir (Zllatar) dhe aty nuk ka ujësjellës fare. Kërkoj që këto shqetësime të merren parasysh.

**Aziz Pacolli** shtroi pyetjen: Pas përfundimit të fabrikës së ujit, a parashihet që Prishtina me rrethinë të mos ketë problem rreth furnizimit me ujë?

**Kimet Zeqa** ngriti shqetësim rreth faturës mujore, duke shtuar se ajo vjen në mënyrë paushalle. Lidhur me këtë problem kam bërë ankesë në ujësjellës dhe asnjë herë nuk kam marrë përgjigje.

**Milazim Vitija** tha se lumenj dhe përroskat, me të gjitha ato mbeturina, të të gjithave fshatrave mbi liqenin e Badovcit, derdhen në liqe, andaj do të ishte mirë që ndërmarra "Pastrimi", t'i mbledhë mbeturinat prej atyre lagjeve, fshatrave, në mënyrë që liqeni të jetë më i pastër.

**Naim Makolli** tha se në lagjen "Kodra e Trimave" reduktimet e ujit janë dy herë në ditë, andaj do të doja një sqarim të qartë lidhur me reduktimet aq të gjata në këtë pjesë. Çështje tjetër është se pse ndodhin edhe dimrit regjimet e njëjta kur kemi temperatura të ulëta dhe nuk kemi harxhime dhe reduktimet janë të njëjta, si verës, ashtu dhe dimrit.

**Hetem Kupina** ngriti shqetësim për mungesën e ujit për lagjet Milevc, Trudë dhe Bërnice.

**Tefik Mehmeti** tha se përveç reduktimeve të shpeshta të ujit, është një dukuri tjetër tejet shqetësuese që kur vjen uji pas reduktimeve, vjen me një presion shumë të madh të ajrit dhe kjo po ndikon shumë keq në prishjen e instalimeve.

Çështje tjetër është se gjatë eliminimit të defekteve vërehet një neglizhencë, papërgjegjësi e punëtorëve, mbesin gropat apo pengesat në rrugë shumë gjatë, nganjëherë edhe nuk mbulohen fare, nuk kthehen në gjendjen e mëparshme.

Apeloj që kjo kompani ta ketë parasysh ndonjë plan për menaxhim, që do ta parandalonte shpenzimin e ujit të pa kontrolluar, sidomos gjatë sezonit të verës.

**Shefki Gashi** kërkoi nga kompania që të bëjë rrallimin e malit afër liqenit të Badovcit, pasi që është mbushur me ferra dhe bimë tjera, me qëllimin që liqeni ta ketë një pamje më të bukur.

**Rrahmon Ismaili** shprehu një shqetësim të qytetarëve të Prishtinës, për reduktimet e ujit që iu bëhen gjatë natës, duke filluar prej orës 23:00. Kërkoi që të shihet mundësia për të bërë ndryshime, që një pjesë tjetër e qytetit ditën të ketë reduktime, kurse pjesa tjetër gjatë natës, pra me sezon apo me muaj, sipas nevojës.

*Lidhur me shqetësimet e ngritura, sqarime të nevojshme paraqiti Gjelosh Vataj, kryeshef ekzekutiv i ujësjellësit rajonal "Prishtina" SH A.*

### **Pika e tretë**

#### **a) Raporti vjetor i komisionit të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale "Pastrimi"**

**Rrahman Ismaili** në emër të GP të LDK-së dhe në cilësinë e anëtarit të Komisionit të aksionarëve, tha se kjo kompani është e licencuar për grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave, si veprimtari primare, ndërsa kryen edhe punë të tjera sekondare, si mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve dhe hapësirave tjera. Ndërmarrja e ka Bordin e drejtorëve dhe Komisionin e auditimit, gjithashtu ka edhe mjetet themelore, si automjete të ndryshme etj. Kjo kompani posedon një pronë të konsiderueshme. Objektivat e kompanisë janë: ngritja e nivelit cilësor të shërbimeve, furnizimi me mekanizëm të nevojshëm, duke i shfrytëzuar burimet e brendshme dhe donacionet, zgjerimi i zonës shërbyese, rregullimi i infrastrukturës për vendosjen e kontejnerëve, vetëdijesimi i qytetarëve dhe institucional, regjistrimi i të gjithë konsumatorëve në zonat e shërbimit, ngritja e shkallës së arkëtimit dhe përkrahja institucionale, gjithashtu edhe zvogëlimin e shpenzimeve.

Komisioni i aksionarëve lidhur me punën e kompanisë për vitin 2011, ka konstatuar si vijon:

Kompania edhe më tutje duhet ta rrisë numrin e konsumatorëve, po ashtu duhet të bëjë përpjekje të rrisë edhe shkallën e arkëtimit, duhet të bëjë përpjekje për uljen e shpenzimeve, përkundër kostos së lartë të shërbimeve, duhet ngritur cilësinë e mëtejme të shërbimeve në punët parësore dhe duhet pasur kujdes në zhvillimin e politikave konkurruese në punët dytësore.

**Aziz Pacolli** në emër të GP të AKR-së, fillimisht paraqiti arsyen e mosnënshkrimit të raportit, duke shtuar se kjo kompani i ka specifikat e veta dhe shikuar në realitet, kjo kompani nuk qëndron mirë ashtu siç është paraqitur në raport. Edhe si aksionar, edhe si komunë, është e rrugës që të merremi pak a shumë me arsyen dhe të kërkojmë që kompania "Pastrimi" të kthehet, të ndahen të gjitha komunat dhe t'i mbetet komunës së Prishtinës.

Si GP nuk e pranojmë, por mënyra e tillë e informimit të aksionarëve është e papëlqyer.

**Shemsi Veseli**, në emër të GP i PDK-së, tha se këtij raportit i mungon një qasje serioze, një analizë e mirëfilltë, profesionale, ku do të bëhej vlerësimi i rezultateve.

Çështja është se ka shkelje dhe është dashur që mos të vijmë në këtë situatë, është dashtë të kishte një transparence dhe të mos mbetej misterioze në raport me nenin 8 të Ligjit për ndërmarrjet publike në kontest me Komunën, ku në mënyrë decisive i përshkruan detyrat e komisionit komunal të aksionarëve.

Është shumë e pakuptimtë që në këtë raport nuk janë paraqitur të dhënat rreth buxhetit, kur dihet se LVL i obligon që në fillim, pra në muajin nëntor, ta pasqyrojnë projektbuxhetin.

Në aspektin e kësaj, konsiderojmë se, për shkak të të dhënave shumë formale që janë dhënë, këtë raport nuk do ta votojmë për miratim.

**Shefqet Sylejmani**, në emër të GP të AAK-së, fillimisht tha se misioni i ynë si këshilltarë në këtë asamble komunale, është që jo vetëm të kritikojmë rastet, dukuritë, problemet e ndërmarrjeve etj. etj. por edhe të ofrojmë zgjidhje. Në frymën e krejt kësaj, e konsideroj të nevojshme që, po qe se pretendojmë që Prishtina të jetë më e pastër se që është, duhet të veprohet në kuptimin e ngritjes së dijes dhe vetëdijes për nevojën e një pastërtie individuale, familjare, të lagjes dhe të qytetit. Edhe me trefishin e këtyre kapaciteteve, ndërmarrja "Pastrimi" nuk mundet të pastrojë ashtu si do të donim, po që se nuk ndërgjegjësohemi ne si qytetarë. Ne duhet të vetëdijësohemi për çështjen e mbajtjes së pastërtisë. Një sugjerim rreth një fakti, që të shikohet mundësia e një diferencimi në çmim, të familjeve me më shumë anëtarë dhe me më pak anëtarë, pra kjo është edhe kërkesë e qytetarëve.

Këtë raport do ta votojmë për miratim.

**Shefki Gashi**, në emër të GP të LDD-së, kërkoi nga anëtarët e Komisionit të aksionarëve që të jenë sa më në nivel të detyrës dhe përgjegjësive të tyre. Sa i përket raportit, tha se nuk po korrespondon numri i shfrytëzimit të ujit, me numrin e familjeve të cilat i paguajnë mbeturinat, pra nga 100.000 parapagues të ujit, për grumbullimin e mbeturinave parapagues po dalin vetëm 39.000.

Gjithashtu kërkoi eliminimin e kontejnerëve për grumbullimin e mbeturinave, pasi që forma e tillë e grumbullimit të mbeturinave prodhon ndyrësira të llojeve të ndryshme.

**Feti Mejdiu**, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, tha se vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna, kompetentët e kësaj ndërmarrje do t'i marrin parasysh dhe çka është e mundur do t'i përmirësojnë.

**Sadri Ramabaja** tha se kryeqendra është më e ndotur në Evropë dhe për këtë gjendje përgjegjëse është kompania "Pastrimi", natyrisht se për këtë nuk mund të përjashtohet edhe kultura e qytetarëve etj.

Në mungesë të një politike të ndëshkimit ndaj kompanive gjegjëse, e kemi gjendjen dhe situatën e tillë. Ne këtu nuk e kemi një politikë të ndëshkimit dhe, natyrisht, shkojnë drejtor në ndërmarrje jo për të vënë rend, por për të përfituar, për të blerë makina luksoze etj. etj. dhe rroga e një drejtori atje është 20 fish më e madhe se e një punëtori. Çmimi i një veture të drejtorit të kësaj ndërmarrje, ka qenë sa buxheti për hapjen e vendeve të reja të punës etj. etj.

**Besa Halimi - Zagragja** shprehu dilemën lidhur me raportin ndërmjet faturimit dhe arkëtimit, duke thënë se, sipas shifrave, të dhënave, del se arkëtimi nga qytetarët është bërë 50%, nga bizneset 40%, ndërsa gjendja është shumë më e mirë në institucionet publike. Si ka mundësi që qytetarët të paguajnë 50%, kurse bizneset 40%?! Cila është arsyeja, nuk u është ofruar shërbimi i duhur dhe kanë refuzuar të paguajnë, nuk është shkuar të mblidhet apo diçka tjetër, ose a kemi ndonjë paraqitje gjyqësore si shoqërohen këto mospagesa, apo diçka lidhur me mosarkëtim? Në këtë raport janë dhënë shifrat për amvisëri, për biznes dhe për institucione vetëm për Komunën e Prishtinës, andaj pyes se cila është arsyeja e zbrastësirave të komunave tjera që nuk janë dhënë shifra për këto shërbime.

**Me shumicë votash u miratua Raporti vjetor i Komisionit të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale "Pastrimi" SHA.**

#### **b) Raporti vjetor i Komisionit të aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale "Hortikultura"**

**Vjollca Rizani**, në emër të anëtarit të Komisionit të aksionarëve, fillimisht tha se ndërmarrja publike komunale "Hortikultura" udhëhiqet nga kryeshefi ekzekutiv, i cili pastaj i përgjigjet Bordit të drejtorëve dhe Bord i raporton Komisionit të aksionarëve, i cili është i caktuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

Duke pasur për bazë planifikimin e biznesit të kësaj ndërmarrjeje, lirisht mund të thuhet se është punuar shumë në ngritjen e sipërfaqeve të reja gjelbëruese gjatë vitit 2011. Gjithashtu kjo ndërmarrje ka pasur një bashkëpunim me Kuvendin e Komunës dhe me institucione të tjera shtetërore.

Kjo ndërmarrje ushtron veprimtarinë edhe me prodhimtari, ku prodhohen lule dhe bimë dekorative. Kjo ndërmarrje është ballafaquar edhe me një varg problemesh ligjore, të cilat deri diku e kanë zvogëluar rolin dhe veprimtarinë e saj, siç janë mungesa e një objekti administrative etj.

Kërkojmë që të krijohet infrastrukturë ligjore për regjistrimin e kësaj ndërmarrjeje në instanca të autorizuar si ndërmarrje publike komunale, të lejohet ndërtimi i një objekti administrativ, si dhe buxhet shtesë për vendosjen e një sistemi të ujitjes për sipërfaqet e gjelbra publike në qytetin e Prishtinës.

**Liridon Restelica** tha se ndërmarrja "Hortikultura" është ndërmarrje e rëndësishme për qytetin, me të cilin edhe Kuvendi i Komunës nuk është marrë seriozisht. Kërkuam fillimisht që të bëhet regjistrimi i ndërmarrjes, por nuk është bërë, si dhe t'i bëhet një hapësirë për stafin e ndërmarrjes etj.

Bordi i kësaj ndërmarrjeje nuk është efikas dhe nuk ka treguar performancë të mirë të punës. Kërkoj, njëherësh edhe lus prapë edhe institucionin komunal që të merret më shumë me ndërmarrjen publike "Hortikultura", të paktën t'i japë mundësi regjistrimit në formë të rregullt e mos të shkoj në këtë formë siç është, se shumë punë do të mund t'i merrte në komunën e Prishtinës "Hortikultura", por vetëm Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është ajo e cila i gjendet pranë kësaj ndërmarrjeje.

**Tefik Mehmeti** tha se ky është një raport gjithpërmbledhës, i cili na jap një pasqyrë të mjaftueshme për gjendjen e kësaj ndërmarrjeje.

Kjo ndërmarrje përkundër vështirësive që u cekën, ka një rezultat të mirë, ka një përmbyllje të vitit me fitim simbolik. Ne pajtohemi me këtë raport, vetëm i dëshirojmë sukses dhe të arritura më të mëdha dhe plotësimin e atyre sugjerimeve apo objektivave që i ka, nëse kërkohet diçka nga ne apo nga Komuna.

**Aziz Pacolli**, në emër të GP të AKR-së, tha se këto raporte që po na sillen për shqyrtim, janë raporte shumë më të zbehta se që kanë qenë vitin e kaluar. Kjo është arsyeja e protestës, të cilën e kam bërë edhe me mos nënshkrimin e raportit të punës të aksionarëve. Kemi disa vërejtje që kanë të bëjnë kryesisht me lidhjen e disa kontratave të paligjshme, duke i dhënë në shfrytëzim parcela komunale dhe sot e kësaj dite komuna nuk është e njoftuar me mënyrën e lidhjes së këtyre kontratave.

Disa herë kam bërë pyetje rreth kontratave që janë bërë në mes “Hortikulturës” ose Komunës për disa objekte hoteliere, dhe për këto nuk kemi marrë përgjigje.

Sa i përket të dhënave në këtë raport për shtimin e hapësirave gjelbëruese, janë tejet shqetësuese, kur dihet se sa sipërfaqe gjelbëruese ka Prishtina. Gjithashtu shqetësuese është edhe dëmtimi i pyllit të Gërmisë dhe për këtë fakt pyes se në çfarë udhë ka rënë udhëheqja e kësaj ndërmarrje me tri subjektet hoteliere, të cilat pa ndërprerë i djegin drunjtë e shëndoshë, ndërsa kalben drunjtë që rrëzohen gjatë periudhës dimërore.

**Shemsi Veseli**, në emër të GP të PDK-së, fillimisht tha se këto raporte janë kopje e raporteve të vitit paraprak, dhe nëse i referohemi Ligjit për ndërmarrjet publike, vërehet qysh në fillim se ka shkelje flagrante. Nëse i referohemi raportit të ndërmarrjes “Hortikultura”, është më shumë përshkrues. Ky raport nuk ka ndonjë analizë, i mungon pasqyra më e detajuar e raportit të buxhetit sipas kodeve, nënkodeve ekonomike buxhetore, zërave të planifikuara e të realizuara. Është e pakuptimtë pasqyrimi i investimeve që ka qenë kapitale sipas projekteve konkrete, në mënyrë që të krijohet njëfarë forme edhe parafytyrimi objektiv mbi shkallën e kryeshmërisë së punëve e projekteve për të cilat është konkluduar, qëndrojnë mangësitë, dobësitë etj. Pra, nuk ka objektiva afatshkurta, afatmesme, afatgjate, nuk i ka sfidat për t’i dhënë alternativa cila është kërkesa e tyre për t’i tejkaluar, pra më shumë është përshkrim.

Me këtë formë se si është hartuar ky raport dhe duke pasur parasysh se i mungojnë elementet esenciale, këtë raport nuk do ta votoj për miratim.

**Shefqet Sylejmani**, në emër të GP të AAK-së, tha se pajtohemi me diskutimet e parafolësve që përafërsisht është njëri prej problemeve jo vetëm me këtë ndërmarrje, por me të gjitha ndërmarrjet komunale të menaxhuara nga strukturat komunale të Prishtinës. Si GP jemi të shqetësuar për dëmtimin gjithnjë e më shumë të sipërfaqeve të gjelbëruara, duke e përmendur edhe rastin e Gërmisë, por edhe të pjesëve tjera të sipërfaqeve të gjelbëruara në qytetin e Prishtinës. Pra, është një shqetësim dhe mbetet pjesë e angazhimit të ndërmarrjes, që të kenë kujdes në drejtimin e ruajtjes dhe kultivimit të këtyre sipërfaqeve gjelbëruese.

Në aspektin e ndihmave që duhet Komuna e Prishtinës t’i japë kësaj ndërmarrjeje, përpos ndihmave financiare, t’i japë edhe disa prej parqeve, pra të jenë në kompetencë të saj. Lidhur me këtë propozoi që pjesa e parkut të kompleksit banesor “Dielli” në lagjen “Kodra e Diellit”, t’i jepet kësaj ndërmarrje në përkujdesje. Do të ishte mirë që kjo ndërmarrje ta zgjeronte fushëveprimtarinë e saj në kultivimin e luleve për ambientet e mbyllura.

Konsideroi shumë të nevojshme që kësaj ndërmarrje, në afatin sa më të shkurtër, t'i dilet në ndihmë për ndërtimin e një objekti për administratën e ndërmarrjes. Si GP e përkrahim këtë raport për miratim.

**Shefki Gashi**, në emër të GP të LDD-së, fillimisht ngriti shqetësim për mos kompensimin e anëtarëve të Komisionit të aksionarëve të këtyre ndërmarrjeve publike lokale.

Vërejtja e parë konsiston tek titulli, kryesisht rreth origjinës së kësaj ndërmarrjeje, e cila në preambulë nuk është precizuar qartë.

Në raport ceket se mirëmbajtjen e varrezave në territorin e komunës së Prishtinës e bën kjo ndërmarrje, por kur është fjala për disa varreza në zonat rurale, kjo nuk merret me mirëmbajtjen e tyre.

Sa i përket ndërtimit të një objekti për vendosjen e administratës, propozoi që, nëse gjendet lokacioni mundshëm, të ndërtohet diku në periferi të qytetit, pasi që kjo ndërmarrje për kryerjen e punëve të saj shfrytëzon mjete motorike, si traktorë, motokultivatorë etj.

E votoj këtë raport, por me qenë pak më me peshë.

**Feti Mehdiu**, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, tha se pajtohem gati me të gjitha ato që u thanë, por u panë disa prej defekteve që janë në këtë raport, andaj dhe kemi një sugjerim, që disa formulime që paraqiten në raport nuk qëndrojnë, siq ishin çështja e dëmtimit të pyjeve dhe mirëmbajtja e varrezave.

Është mirë që të merret puna pak më me seriozitet dhe të mos përsëriten gabimet e njëjta, po të shkojmë secilën herë të ndryshojmë diçka edhe të plotësojmë gjërat që iu duhen këtyre qytetarëve për të mirën e tyre.

E përkrahim miratimin e këtij raporti, me shpresën se edhe prej këtij raporti, me këto të mira dhe të këqija, do të mësojmë diçka që herën tjetër t'i bëjmë më mirë.

**Sadri Ramabaja**, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, tha se ky raport nuk është produkt i këtyre tri komisioneve, tri grupimeve të punës, por është "sa për të kaluar lumin".

Ne kemi analizuar këtë raport dhe nuk kemi vërejtur ndryshime prej atij të vitit të kaluar, andaj nuk duam që t'i përsërisim vazhdimisht vërejtjet e njëjta, sepse nuk është serioze as kjo formë e raportimit, as puna që bëhet.

Nëse ka pasur keqpërdorime dhe shkatërrim të pyjeve, siç u theksua nga parafolësit këtu, është si rezultat i varfërisë së thellë të një pjese të qytetarëve, por ajo që e shtrojmë ne është se këto keqpërdorime janë evidente, por a është ngritur ndonjë padi penale në institucionet përkatëse, pra në gjykatën përkatëse të komunës, në raport nuk theksohet.

Çështja e dytë, është se ndërmarrjet publike do duhej të zgjeronin aktivitetin prodhues e mos të blejmë edhe lule nga Kina, por t'i prodhojmë këtu dhe kjo ide nga ana jonë është për t'u përshëndetur.

Çështje tjetër që nuk shihet në këtë raport, është se nuk ka pasqyrë të saktë të të ardhurave të drejtuesve, ndërkaq ne kemi pasqyrën e të ardhurave të punëtorëve. Sido çoftë, për këtë raport nuk votoj, sepse jemi të përcaktuar për çështje formale.

**Liridon Restelica** u shpreh se arsyeja e vetme për nënshtrimin e këtij raporti është për shkak se "Hortikultura" gjithë shtresën e punëtorëve që e ka, është shtresa më e ulët e mundshme e njerëzve që jetojnë në këtë rrethinë dhe e vetmja arsye është pse unë e kam nënshkruar këtë raport e jo për arsye tjera.

**Naim Makolli** kërkoi të dijë se Parku te varri i Presidentit Rugova a është nën përkujdesin e Hortikulturës, apo ndonjë kompanie tjetër. Nëse është nën përkujdesje të Hortikulturës, apeloj që shtigjet që i mbush me lule, t'i ndryshojë njëherë e përgjithmonë dhe të mbjellë lule që i kanë hije atij parkut, pasi që me ato lule që janë aty e kemi një pamje të zymtë.

**Me shumicë votash u miratua Raporti vjetor i komisionit të aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale "Hortikultura".**

**c) Raporti vjetor i Komisionit të aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale "Termokos"**

**Mustafë Krasniqi**, në emër të GP të LDK-së dhe në cilësinë e anëtarit të Komisionit të aksionarëve, tha se "Termokos" është shoqëri aksionare, e licencuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë dhe veprimtaria e saj është prodhimi i energjisë ngrohëse, shpërndarja e energjisë ngrohëse dhe furnizimi i konsumatorëve me energji ngrohëse. Komisioni i aksionarëve ka mbikëqyrë veprimtarinë e punës së Bordit të drejtorëve, ku vërtetohet nga raporti i punës së ndërmarrjes organizimi, objektivat, rezultatet dhe vështirësitë e ndërmarrjes.

Në raportin e Komisionit të aksionarëve janë përmbledhur disa nga zhvillimet kryesore gjatë vitit 2011: zgjedhja e Bordit të ri dhe e kryeshefit ekzekutiv, Statuti i ri i miratuar, plani i biznesit për vitin 2012, plani për ngritjen e arkëtimit, duke përfshirë edhe borxhet e vjetra, uljet e pagave të pjesës menaxheriale etj.

NPK "Termokos" gjatë vitit 2011 është përcjellë me sfida të mëdha, ngritje të vazhdueshme të çmimit të mazutit, borxhet e vjetra etj.

Me gjithë vështirësitë që ka pasur ndërmarrja gjatë vitit 2011, Bordi i drejtorëve dhe kryeshefi ekzekutiv kanë bërë planin e veprimit për sezonin ngrohës 2011- 2012, planin e biznesit për vitin 2012, planin e rritjes së arkëtimit, konsolidimin e administratës, uljen e shpenzimeve operacionale dhe kthimin e besimit të konsumatorëve, duke bërë përmirësimin e cilësisë së ngrohjes dhe faturimit real, gjë që ka ndikuar në shkallën e ngritjes së arkëtimit. E një rëndësie të veçantë është edhe nënshkrimi i marrëveshjes financiare me Bankën Gjermane për Zhvillim, Komisionin Evropian dhe Ministrinë e Financave lidhur me realizimin e projektit të kogjenerimit.

Komisioni i aksionarëve vlerëson se ky raport është i mirë dhe real, dhe i propozon këtij Kuvendi miratimin e tij.

**Milazim Vitija**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të aksionarëve të NPK "Termokos", tha se kjo ndërmarrje, krahasuar me ndërmarrjet tjera, është pak sa ma specifike, pasi që kemi të bëjmë me një ndërmarrje që varet 100% prej mazutit, që do të thotë në berzhë çdo vit është duke u shtrenjtuar çmimi i tij.

Si komision i aksionarëve jo që kemi përfituar diçka, por kemi krijuar shpenzime tona edhe të telefonit, edhe të rrugës edhe të gjithave, kemi pas punë gjatë këtij viti sepse është ndërruar Bordi i drejtorëve, është ndërruar kryeshefi ekzekutiv dhe tash e shohim se si do të shkojnë punët.

Si GP e përkrahim këtë raport për miratim.



**Shemsi Veseli**, në emër të GP të PDK-së, tha se Komisioni i aksionarëve nuk iu ka përmbajtur ligjit për ndërmarrjet publike.

Në raport nuk shkruhet asnjë fjalë për mbikëqyrjen që duhet ta ushtrojë Komisioni i aksionarëve, gjithashtu nuk shkruhet asnjë fjalë as për auditorin e brendshëm etj.

Çështja më shqetësuese është shkëlja e Ligji për vetëqeverisje lokale, e që nuk jepet asnjë përgjigje rreth planifikimit të buxhetit. Në anën tjetër, që është shumë shqetësuese dhe e habitshme, është se nuk paraqiten emrat e drejtorëve, profesioni, andaj dhe në këtë drejtim nuk jepet asnjë sqarim. Në raport nuk shkruhet se cilat masa janë marrë, çfarë veprimesh janë marrë, cilat janë alternativat e mundshme, pse faktikisht ka pas këtu rrjedhje të mazutit, ndërrim të gypave që kanë qenë të vjetruar, që faktikisht të gjitha këto nuk janë të sqaruara.

Me këtë formë të raporteve po krijojmë hapësirë në ndërmarrje publike lokale edhe me keqpërdorur edhe misionin çfarë e kanë, edhe me i keqpërdorur përgjegjësitë çfarë i kanë në raport me Kuvendin e Komunës.

GP i PDK-së nuk do ta votojë për miratim këtë raport.

**Shefqet Sylejmani**, në emër të GP të AAK-së, tha se edhe kjo ndërmarrje përballet me probleme të ndryshme të akumuluar vite me radhë. Mendoj se do të duhej të përmendej një borxh prej 16 milion euro nga qytetarët shfrytëzues të shërbimeve të Termokosit, e në anën tjetër të kërkohet diçka, që në realitet do duhej të ishte normale mendoj që është absurde, prandaj mbetet detyrë e përbashkët e jona që të angazhohemi në të gjitha tejkalimet e këtyre vështirësive që i ka kjo dhe ndërmarrjet e tjera e në menaxhim objektivisht të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Si GP i AAK-së e përkrahim edhe do ta votojmë për miratim këtë raport.

**Shefki Gashi**, në emër të GP të LDD-së, tha se në raport është dashtë të ceket koha prej cilës datë ka pasur ose nuk ka pasur nxehje, andaj këto për mua janë me rëndësi. Për të qenë sa më funksionale nxehja, është më se e domosdoshme që të përmirësohet teknologjia, pasi që ajo teknologji është shumë e vjetër, pra të kërkohet ndonjë donacion ose subvencion dhe të investohet që të jetë diçka më e modernizuar dhe të ecet me kohën. Si Kuvend jemi të autorizuar të kërkojmë shërbime sa më cilësore për qytetarë tanë.

**Feti Mehdiu**, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, tha se pajtohem me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, por Termokosit i mbetet që të mendoj për të siguruar nxehje për qytetarët e Prishtinës jo në mbështetje të mazutit, por të përqendrohet për njëfarë sistemi tjetër, pra me thëngjill.

**Besa Halimi - Zagragja** tha se këtyre raporteve në përgjithësi iu mungojnë pasqyrat financiare, të cilat janë a, b, c -ja e një raporti pune.

Ky raport domosdo është dashtë t'i përmbajë pasqyrat financiare, të cilat janë në fakt a, b, c -ja e një përshkrimi të një raporti pune, sepse edhe në një projekt sado të vogël, sado të thjeshtë, do të duhej të ketë një shoqërim të shpenzimeve, pasqyrave financiare. Kjo do duhej të ishte me qëllim të informimit lidhur me gjithçka që korrespondon me këto ndërmarrje. Nëse konstatojmë se duhen të jenë, atëherë duhet të dihet edhe pse nuk janë.

**Sadri Ramabaja**, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, si shqetësim për këtë raport ngriti tri çështje: 1. ofrimi i ngrohjes, që ishte jashtëzakonisht e dobët, 2. faturimi jo real, që konsiston në plaçkitjen e qytetarëve dhe 3. çështja e besimit, respektivisht mosbesimit të konsumatorëve.

Sa i përket transparencës, mund të thuhet se është një mungesë e plotë e saj dhe për ilustrim konkret mund të merren lagjet "Ulpiana" dhe "Dardania", ku faturat e shpenzimeve nuk korrespondojnë, sipas raportit të qytetarëve, me nxehtjen që iu është ofruar gjatë sezonit 2011.

Si përfundim, mund të konstatohet se qëndrueshmëria e ngrohjes nuk është ngritur, përkundrazi, ka rënë. Urojmë që së paku me projektin e kogjenerimit, të ecën puna më mirë.

**Me shumicë votash, pesë kundër (Shemsi Veseli, Donika Surdulli, Besa Halimi - Zagragja, Lumnije Rama dhe Sadri Ramabaja), u miratua Raporti vjetor i Komisionit të aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale "Termokos".**

#### **Pika e katërt**

##### **Pyetje dhe përgjigje**

**Mejreme Berisha** ngiti një shqetësim rreth bartjes së mësuesve për në fshatin Koliq, duke shtuar se auto-kombi i cili ka bartur këta mësues në relacionin prej Xhamisë së Llapit deri në Koliq, vetëm gjatë procesit mësimor, dhe kombi kthehet në ora 13:00, shtrohet pyetja se çka do të bëjnë këta njerëz gjatë verës.

Lidhur me problemin e shtruar nga znj. Berisha, **Agim Gashi** tha se kjo është kontratë që realizohet përmes Drejtorisë së Arsimit, ndërsa atje operon një nën kontraktor po ashtu me kombi në kuadër të kompanisë "Trafiku Urban".

Ata do ta mbajnë një orar që e kanë të rregulluar në bazë të marrëveshjes.

Ne presim shumë shpejt që komuna e Prishtinës do të rregullojë tenderin për partneritet, do të rregullojë gjendjen e trafikut të udhëtarëve në komunën e Prishtinës.

#### **Pika e pestë**

##### **Të ndryshme**

**Lidhur me shpërndarjen e një pamfleti nga ana e z. Ramabaja para se të filloj mbledhja, kryesuesi tha se këshilltari ka shkelur Rregulloren e Kuvendit, pasi që u konstatua se në mënyrë të njëanshme është shpërndarë pamflet pa emër.**

**Sadri Ramabaja** tha se me këtë dokument janë njoftuar pjesa dërmuese e këshilltarëve, andaj dhe nuk do ta lexoj.

Çështje e parë është se shprehi indinjatën publikisht, sepse si qytetar jam ndier shumë i fyer për histerizmin e kryetarit tonë dhe kjo ka të bëjë me komunën tonë; e dyta, sepse kam qenë pjesë e atyre strukturave dhe bashkëpunëtor i Ibrahim Kelmendit, njërit prej tre themeluesve të Lëvizjes Popullore të Republikës së Kosovës; e treta, sepse reagimin e sjell në emër tim, si këshilltar dhe si qytetar e jo në emër të Lëvizjes Vetëvendosje.

**Flamur Shala** tha se ky Kuvend, prej sa jam unë anëtarë i tij, ka bërë përpjekje të vazhdueshme të japë kontributin e tij në qeverisjen e mirë të kryeqytetit në përmbushjen e kërkesave të qytetarëve, çoftë të përfaqësuar politikisht, dhe këto të dyja kanë qenë të sublimuara në një mënyrë ose në një tjetër.

Është e natyrshme që jo të gjithë e kemi një qasje të njëjlojshme ndaj çështjeve të caktuara, sepse jemi përfaqësues të subjekteve të caktuara politike, por elementi i rëndësishëm i transparencës është arritur ku secili prej nesh, duke dhënë mendimin dhe duke përfaqësuar politikisht, jo rrallë kemi qenë

unik në çështjet e caktuara, sepse kemi përfaqësuar kërkesa të njëjta të qytetarëve.

Dikush është duke e keqpërdorur aq thellë Kuvendin, duke e mbështjellë me paraqitjet e veta, me njëfarë intelektualizmi me nja 4-5 fjali të lexuara nëpër libra apo vepra të caktuara teorike politike e ku ta di unë, duke u shkëputur rrënjësisht nga kërkesat e caktuara edhe kërkesa të natyrshme të qytetarëve tanë, pra duke u shkëputur krejtësisht nga këto kërkesa, del dhe keqpërdor Kuvendin dhe del jashtë çdo norme të respektimit të rregulloreve dhe të ligjeve që vetë i kemi miratuar.

Në këtë kuptim, pa dashur ta zgjas, është edhe ky pamflet, i cili mua më ngjet, me ju thënë të drejtën, sikur do pamflete të fotokopjuara që dalin nëpër

dokumente, libra që nxjerrin tash historianët tanë të viteve të 50-ta, që dalin të nënshkruara nga byroistët politikë stalinistë të atyre viteve, sepse ky popull në kontinuitet po vazhdon të tregojë kush ku ka qenë, kush ku është tani dhe sigurisht kush ku do të jetë në kuptimin e mirëfilltë të kësaj që po e them.

Dikush mendojnë se po iu cenohet e drejta, e ata vet, në emër të së drejtës së fjalës dhe në emër të lirisë së shprehjes, keqpërdorin aq thellë dinjitetin tonë këtu brenda këtij kuvendi, andaj i lus që kjo të ndërpritet, sepse është cenim i drejtpërdrejtë i secilit prej nesh.

**Aziz Pacolli** tha se vërtetë është e dhimbshme të vijmë në një pozitë të tillë në këtë kuvend, se vërtetë është një mjegullnajë në skenën politike në Kosovë prej atyre që kanë shpërndarë pamflete më herët, dhe që vazhdojnë të shpërndajnë prapë. Kuvendi i Komunës ka obligime të tjera, ka detyra të tjera dhe kisha kërkuar që në të ardhmen të jenë më të kujdesshëm, mos të lejohen me u shpërnda kësi lloj pamfletesh, sepse po dalim në pozitë shumë të keqe. Unë jam për atë që të reagohet, si Kuvend komunal, rreth këtij pamfleti.

**Vjollca Dibra - Ibrahim** tha se është për të ardhur keq për veprimin si ky, kur një anëtar i këtij kuvendi shpërndan kësi pamfleti, sepse të gjithë, në një mënyrë a në një tjetër, kemi qenë të prekur nga koha kur është dashur të prekemi. Tani nuk është koha e shpërndarjes së këtyre pamfleteve dhe e këtyre sjelljeve nëpër institucione, siç është edhe ky kuvend.

Zotëri Ramabaja ndër të tjera thotë se e kam të qartë se është reflektim i dukshëm i mungesës së kulturës politike, në fakt është reflektim i qartë i mungesës së kulturës politike të vet z. Ramabaja. Kërkoj që të merren masa ndaj këtyre anëtarëve që përpiqen të shpërfillin dhe të njollosin njerëzit në këtë mënyrë, të cilët në asnjë mënyrë nuk e meritojnë këtë. Mendoj që ne të gjithë, si Kuvend komunal, të distancohemi nga ky veprim i z. Ramabaja.

**Shefki Gashi** tha se Kuvendi komunal nuk është kompetent të merret me këto çështje. Këto janë çështje me të cilat duhet të merret gjyqësia, prokuroria dhe të gjitha organet tjera.

Në emër të një pjese të grupeve parlamentare, Kuvendi i Komunës nxjerr këtë deklaratë:

***Deklaratë e Kuvendit të Komunës së Prishtinës**  
Prishtinë, 22 mars 2012*

*Kuvendi i Komunës së Prishtinës reagon ndaj të gjitha shpifjeve dhe dezinformatave që po bëhen në emër të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, prof. dr. Isa Mustafës.*

*Në asnjë shoqëri, në asnjë kohë të shoqërisë kosovare nuk janë servuar të pavërtetat denigruese për individ apo personalitetet siç po veprohet ditët e fundit, mbështetur nga disa medie dhe qarqe të caktuara.*

*Këto fyerje bien ndesh me moralin e shoqërisë dhe familjeve kosovare. Kuvendi i Komunës vlerëson se këto shpifje janë të orkestruara nga individë me qarqe të caktuara politike dhe media në Kosovë për të arritur qëllime të caktuara politike dhe për të tërhequr vëmendjen nga shkelësit e vërtet të ligjit.*

*Kuvendi i Komunës kërkon që këto shpifje të ndalen menjëherë, sepse një praktikë e tillë është në kundërshtim me vlerat e mirëfillta demokratike dhe parimet e shoqërisë kosovare.*

Me shumicë absolute votash u miratua deklarata e Kuvendit të Komunës.

***Mbledhja mbaroi në orën 15:00.***

**PROCESMBAJTËSI**  
**Zijadin Gashi**

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Sami Hamiti, ecc. i dipl.**